

V E N D I M

Nr. 90 Date 06.08. 2008

**PER
LICENSIMIN E SHOQERISE “BIOPOWER GREEN ENERGY” SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa a, 8, si dhe 15 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, neneve 5, 13 si dhe 14, te “Rregullores per Procedurat e Licensimit” te miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21, datë 04.04.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.08.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria “Biopower Green Energy” sh.p.k, per tu licensuar ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik me ere si dhe prodhimin e energjise elektrike nga Parku Eolik BPGE1 dhe BPGE 2,


Konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave per shqyrtimin e aplikimit te “Biopower Green Energy” sh.p.k,, ka nisur me marrjen e vendimit nr. 54 date 29.05.2008.
2. Ligji nr. 9913, date 5.5.2008 ” Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nuk parashikon te kete fuqi prapavepruese per aplikimet e paraqitura para hyrjes ne fuqi te ketij ligji.
3. Ne lidhje me ndertimin e ketij parku, shoqeria “Biopower Green Energy” sh.p.k, ne aplikimin e saj per tu licensuar ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrike me ere dhe prodhimin e energjise elektrike, e bazon studimin e prefizibilitetit ne te dhena historike te rregjistruara te eres, te matura ne lartesi te ndryshme nga ato ne te cilat do te punojne gjeneratoret.
4. Oponenca tekniko –ekonomike eshte paraqitur prane AKBN e cila ende nuk eshte shprehur mbi kete projekt
5. Ligji per Sektorin e Energjise Elektrike parashikon ne nenin 15 autoritetin e ERE-s per vendosjen e kushteve te çdo license

Per sa konstatuar, Bordi i Komisionereve te ERE-s,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve




Vendosi:

1. Të licensoj shoqerine “Biopower Green Energy” sh.p.k ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik me ere si dhe prodhimin e energjise elektrike nga parqet eolike BPGE 1 dhe BPGE 2, me kusht zbatimin perveç sa parashikuar ne licensen tip te miratuar nga Bordi i Komisionereve per aktivitetin e ndertimit dhe prodhimit te energjise elektrike, edhe te zbatimit te kushteve te meposhteme:
 - a. Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtezohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Percaktimi në këtë studim i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e leshimit te licenses dhe perpara fillimit te zbatimit te punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.
 - b. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k duhet paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nenshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjellta, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.
 - c. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k, do të respektojë detyrimet e Shërbimit Publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
 - d. Shoqeria duhet te paraqese prane ERE-s oponencen tekniko- ekonomike nga eksperte te licnesuar brenda 60 diteve nga leshimi i licneses.
 - e. Koha e zbatimit e te gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke ju referuar datës së leshimit të licencës të jetë 36 muaj.
 - f. Mospermbushja e pikave te mesiperme ne afatet e percaktuara e ben licensen te pavlefshme.
2. Afati i vlefshmerise se licenses te jete 30 vjet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per vendimin e Bordit te Komsionereve te ERE-s,

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN
Nr.90 date 06.08.2008

PER
LICENSIMIN E SHOQERISE "UNION EOLICA ALBANIA" SH.P.K

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____